

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaMur[®]-1000 SP

LLAÇ RINOVUES GATI PËR APLIKIM MANUAL OSE ME MAKINERI MBI MURET ME LAGËSHTI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaMur[®]-1000 SP është llaç rinovues gati për përdorim, me porozitet të lartë, transpirues dhe dehumidifikues në përputhje me Kategorinë R, EN 998-1. Përdor agregate të posaçme me peshë të lehtë, gëlqere dhe çimento. SikaMur[®]-1000 SP është i përshtatshëm për trajtimin dhe rehabilitimin e mureve që janë subjekt i lagështisë ngjitëse, duke përmirësuar gjithashtu performancën termike. SikaMur[®]-1000 SP është krijuar për aplikime manuale dhe me makineri.

PËRDORIMET

SikaMur[®]-1000 SP përdoret për dehumidifikimin e mureve me lagështi
Përdoret në mjedise të brendshme e të jashtme mbi nënshtresat te mëposhtme:

- Mur solid me tulla
- Mur i ndërtuar me gurë të thyer ose të përzierë
- Mur me tulla guri gëlqeror
- Bllloqe pa kalcifikim

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Difuzion i lartë avujsh, lejon avullimin e lagështisë së mbajtur tek muri
- Rezistencë ndaj migrimit të kripërave, efloreshencës dhe mykut
- Nuk kërkohet trajtim kundër kripërave
- Veti izolimi termik
- Ndërkapet mirë mbi nënshtresë
- Dendësi e ulët, material me peshë të lehtë
- Punueshmëri e mirë
- Aplikim i lehtë manual ose me makineri

MIRATIME / STANDARDE

Llaç rinovues kategoria R sipas EN 998-1:2010 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	gëlqere, çimento, rërë dhe agregate të posaçme me peshë të lehtë
Ambalazhi	thes letre me veshje të brendshme 20 kg
Paraqitja / Ngjyra	pluhur gri e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në vend të thatë në ambalazhin original dhe të padëmtuar
Dendësia	~0.975 kg/L
Përmasa maksimale e kokrrizës	Dmax : 1.4 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	≥ 4.00 MPa	(EN 1015-11)
---------------------------	------------	--------------

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1.1 MPa dështim kohezioni tek llaçi	(1015-12)
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria A1	(EN 13501-1)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	$\mu \leq 15$	(1015-19)
Përthithja e ujit	≥ 0.3 kg/m ²	(EN 1015-18)
Depërtimi i ujit pas provës së përthithjes kapilare	3 mm	(EN 1015-18)
Përçueshmëria termike	0.27 W/mK	(EN 1745:2002 Table A.12)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	SikaMur®-1000 SP është pjesë e sistemit rehabilitues Sika® për rinovimin e mureve me lagështi dhe përdoret në mënyrë ideale në kombinim me:	
	SikaMur® InjectoCream-100	Shtresë e injektueshme me bazë silani kundër lagështisë për trajtimin e lagështisë ngjitëse horizontale
	SikaMur® Finish	Shtresë përfundimtare gati për përdorim me bazë gëlqereje dhe transpirim të lartë për përfundimin e SikaMur®-1000 SP ose llaçeve rinovues dehumidifikues SikaMur®-Dry
	SikaMur® Color I ose E	Bojë me ngjyrë me bazë gëlqereje për suva ose allçi tradicionale ose dehumidifikuese, për përfundimin dhe mbrojtjen e SikaMur® Finish

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	5.2–5.6 litra ujë i pastër për 20 kg
Konsumimi	20 kg pluhur për 20 mm trashësi shtrese për 1 m ²
Trashësia e shtresës	Trashësia totale e aplikuar duhet të jetë të paktën 20 mm
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +35 °C max.
Koha e punueshmërisë	30 minuta në 20 °C
Koha e pritjes / mbiveshja	Prisni të paktën 15 ditë përpara aplikimit të SikaMur® Finish mbi SikaMur®-1000 SP për parandalimin e plasaritjeve mbi sipërfaqen e përfunduar

UDHËZIME APLIKIMI

departamentin teknik Sika për këshilla.

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Heqje e plotë e veshjes së dëmtuar dhe të shkëputur të suvasë, duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për fugat midis tullave/gurëve. Fugat e mureve duhet të zhvishen deri në thellësinë ~ 20-30 mm, pa dobësuar qëndrueshmërinë e murit.
- Heqja e suvasë ose allçisë ekzistuese duhet të arrijë deri në nivelin më të lartë të sipërfaqes së dëmtuar, plus tre herë trashësinë e murit. (lartësi totale pastrimi = lartësi dëmtimi + gjatësi 3 x të trashësisë së murit).
- Pastroni nënshtresën e murit me curril uji në presion të lartë (200-400 bar), veçanërisht përgjatë fugave. Për depozita të posaçme si bitumi, etj. kontaktoni me

PËRZIERJA

Përziemi me një aks mikseri me rpm të ulët ose me mikser me kovë rrotulluese derisa të arrihet një konsistencë e lëmuar, e njëtrajtshme dhe pa kokrriza. Mos përziemi më tepër se 3 minuta për të shmangur bllokimin e ajrit brenda llaçit.

APLIKIMI

- Aplikimi duhet të kryhet të paktën në 2 veshje, në fillim një shtresë paraprake ndërkapjeje që ndiqet me një shtresë suvatimi
- Shtresa e ndërkapjes duhet të vendoset me konsistencë të lëngët
- Shtresa e dytë duhet të vendoset mbi shtresën e ndërkapjes kur kjo të jetë mpiksur.
- Spërkatni produktin me pajisjen e përshtatshme të spërkatjes mekanike të lëngët me parametrat e mëposhtëm teknik:

Kapaciteti i pompimit	minimumi 22 l/min
Ujë për konsistencë tiksotropike	~350 l/orë
Gjatësia e tubit	max. 15 m
Diametri i brendshëm i tubit	min. 25 mm (rekomandohet 35 mm)
Llojet tipike	Putzmeister PFT G4 ose G5

- Është i mundur aplikimi manual me teknika tradicionale
- Lëmoni sipërfaqen me dru për të mos mbyllur porët e sipërfaqes
- Trashësia totale e 2 shtresave duhet të jetë min. 20 mm

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat me ujë përpara ngurtësimit të llaçit

KUFIZIME

- Nuk duhet të përdoren vegla hekuri ose plastike, sepse mbyllin teksturën/poret e sipërfaqes dhe parandalojnë transpirimin e llaçit
- Përfundoni sipërfaqen duke përdorur SikaMur® Finish, një llaç i imët suvatimi me bazë gëlqereje me transpirim të lartë
- Për lyerje të sipërfaqes përdorni produkte me veprim minimal pengues të avujve (μ të mos kalojë 10) për parandalimin e flluskave dhe shkëputjeve p.sh. SikaMur® Color I për përdorim të brendshëm ose E për përdorim të jashtëm
- Mund të shfaqen plasaritje të vogla në varësi të llojit të nënshtresës mbi të cilën është aplikuar produkti dhe për shkak të fuqisë së madhe dehumidifikuese të SikaMur®-1000 SP
- Të mos aplikohet mbi mure që janë subjekt i presionit hidrostatik të ujit, kontaktoni shërbimin teknik për këshilla
- Llaçit i freskët i aplikuar duhet të mbahet i njomë për disa orë duke e mbrotjur nga era dhe rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor
- Të mbrohet nga shiu për të paktën 6 orë pas aplikimit

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaMur®-1000 SP

Mars 2019, Botimi 01.01

020405020020000023

SikaMur-1000SP-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf